# FLETORJA ZYRTARE
## E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

www.qbz.gov.al

Viti: 2021 – Numri: 114

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

**Tiranë – E hënë, 19 korrik 2021**


## PËRMBAJTJA


| | | Faqe |
|---|---|---|
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 435, datë 15.7.2021 | Për shpronësimin për interes publik të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit "Për ndërtimin e banesave për strehim social, Roskovec"........................... | 10445 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 436, datë 15.7.2021 | Për disa ndryshime në vendimin nr. 803, datë 30.9.2015, të Këshillit të Ministrave, "Për vënien në dispozicion të shoqërisë Trans Adriatic Pipeline AG (TAP AG), nëpërmjet marrjes në përdorim të përhershëm të sipërfaqeve të tokave shtetërore që preken nga ndërtimi i infrastrukturës mbi tokë të projektit të Gazsjellësit Trans Adriatik (projekti TAP)"................................................................ | 10446 |
| Urdhër i ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr. 99/2, datë 29.6.2021 | Për një ndryshim në urdhrin nr. 99, datë 10.2.2021, "Për kufizimin e lëvizjes brenda vendit", të ndryshuar.................................................. | 10451 |
| Urdhër i ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr. 270/2, datë 30.6.2021 | Për një ndryshim dhe një shtesë në urdhrin nr. 351, datë 29.5.2020, "Për marrjen e masave të veçanta dhe kufizimeve për parandalimin e përhapjes së COVID-19", të ndryshuar.............................................. | 10451 |
| Urdhër i ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr. 321, datë 29.6.2021 | Për shfuqizimin e urdhrit nr. 326, datë 15.5.2020, "Për kufizimin e aktiviteteve sportive", të ndryshuar, dhe lejimin e kampionateve sportive me prezencë të tifozëve me kapacitete të reduktuara deri në 30%........................................................................................ | 10451 |
| Urdhër i ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr. 324, datë 6.7.2021 | Për shfuqizimin e urdhrit të ministrit nr. 131, datë 8.3.2020, "Për ndalimin e eksportit të barnave dhe pajisjeve mjekësore".................. | 10452 |
| Kërkesë e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 304, datë 15.7.2021 | Për shpronësim për interes publik të pasurive, pronë private, që preken nga zbatimi i projektit "Përmirësimi i furnizimit me ujë të pijshëm për qytetin e Roskovecit"........................................................ | 10452 |

**VENDIM**
**Nr. 435, datë 15.7.2021**

## PËR SHPRONËSIMIN PËR INTERES PUBLIK TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT "PËR NDËRTIMIN E BANESAVE PËR STREHIM SOCIAL, ROSKOVEC"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik", të ndryshuar; të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 137/2020, "Për buxhetin e vitit 2021", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin për interes publik të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit "Për ndërtimin e banesave për strehim social, Roskovec".
2. Shpronësimi bëhet në favor të Bashkisë Roskovec.
3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, që shpronësohen, të kompensohen, në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për pasurinë e llojit "tokë truall", me një vlerë të përgjithshme prej 741 000 (shtatëqind e dyzet e një mijë) lekësh.
4. Masa e shpërblimit për pronarët që shpronësohen është 741 000 (shtatëqind e dyzet e një mijë) lekë dhe do të përballohet nga Bashkia Roskovec.
5. Vlera e shpenzimeve procedurale, në masën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, të përballohet nga Bashkia Roskovec.
6. Shpronësimi të fillojë menjëherë pas botimit të këtij vendimi në Fletoren Zyrtare dhe afati i përfundimit të shpronësimit të jetë brenda 3 (tre) muajve nga data e hyrjes në fuqi të tij.
7. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, të pasqyruar në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, të kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin justifikues për likuidim, pranë Bashkisë Roskovec.
8. Bashkia Roskovec të kryejë procedurat për likuidimin e pronarëve të shpronësuar, sipas përcaktimeve të bëra në këtë vendim.
9. Afati i fillimit dhe i përfundimit të punimeve të jetë në përputhje me afatet e parashikuara nga Bashkia Roskovec.
10. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, të nisë procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale të regjistrimit, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar dhe të bëjë regjistrimin e kalimit të pronësisë për pasuritë e shpronësuara në favor të shtetit.
11. Agjencia Shtetërore e Kadastrës të pezullojë të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara deri në momentin kur do të realizohen procesi i hedhjes së gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale të regjistrimit dhe regjistrimi i kalimit të pronësisë në favor të shtetit për pasuritë e shpronësuara.
12. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Bashkia Roskovec, Agjencia Shtetërore e Kadastrës dhe Agjencia Shtetërore për Shpronësimin për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
**Erion Braçe**

**LISTA EMËRORE, PËRFUNDIMTARE, E BASHKËPRONARËVE TË PASURISË, PRONË PRIVATE, QË PREKET NGA REALIZIMI I PROJEKTIT "PËR NDËRTIMIN E BANESAVE PËR STREHIM SOCIAL, ROSKOVEC"**

| Nr. | Emër Atësi Mbiemër | ZK | Nr. i pasurisë | Sip. e prekur truall (m²) | Çmimi për truall (lekë/m²) | Vlera e truallit | Sip. e ndërtesës së prekur | Çmimi i ndërtesës lekë/m² | Vlera e ndërtesës | Vlera totale | Shënime sqaruese |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Bashkëpronarët: Ilirjan Kongoli, Hajrie Shehu, Ymid Resuli, Mehdije Hoxha, Eqerem Risilia, Kujtim Kryeziu, Xheladin kryeziu, Pranvera Kryeziu, Muharrem Resuli, Et'hem Resuli, Senije Resuli, Umberto Resuli, Rubie Risilia, Jolldiz Bedini | 3196 | 3/294 | 1500 | 494 | 741000 | 0 | 30000 | 0 | 741000 | **Konfirmuar nga ASHK Drejtoria Vendore Fier** |
| SHUMA | Vlera totale paraprake | | | 1500 | | 741000 | 0 | | 0 | 741000 | |

# VENDIM
# Nr. 436, datë 15.7.2021

## PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 803, DATË 30.9.2015, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR VËNIEN NË DISPOZICION TË SHOQËRISË TRANS ADRIATIC PIPELINE AG (TAP AG), NËPËRMJET MARRJES NË PËRDORIM TË PËRHERSHËM TË SIPËRFAQEVE TË TOKAVE SHTETËRORE QË PREKEN NGA NDËRTIMI I INFRASTRUKTURËS MBI TOKË TË PROJEKTIT TË GAZSJELLËSIT TRANS ADRIATIK (PROJEKTI TAP)"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të pikave 16 e 27.1, të marrëveshjes me qeverinë e vendit pritës dhe të pjesëve 1 e 3, të shtojcës 1, të marrëveshjes me qeverinë e vendit pritës, ndërmjet Republikës së Shqipërisë, duke vepruar nëpërmjet Këshillit të Ministrave, dhe Trans Adriatic Pipeline AG, lidhur me projektin e Gazsjellësit Trans Adriatik (projekti TAP), ratifikuar me ligjin nr. 116/2013, "Për ratifikimin e marrëveshjes me qeverinë e vendit pritës, ndërmjet Republikës së Shqipërisë, duke vepruar nëpërmjet Këshillit të Ministrave, dhe Trans Adriatic Pipeline AG, lidhur me projektin e Gazsjellësit Trans Adriatik (projekti TAP), si dhe të marrëveshjes, ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave, dhe Trans Adriatic Pipeline AG, në lidhje me projektin e Gazsjellësit Trans Adriatik (projekti TAP)", me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në vendimin nr. 803, datë 30.9.2015, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime:

1. Pika 1 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"1. Vënien në dispozicion të shoqërisë Trans Adriatic Pipeline AG (TAP AG), nëpërmjet marrjes në përdorim të përhershëm me kompensim të sipërfaqes totale të tokës shtetërore prej 87 363.01 (tetëdhjetë e shtatë mijë e treqind e gjashtëdhjetë e tre pikë zero një) m², që preken nga ndërtimi i infrastrukturës mbi tokë të projektit të Gazsjellësit Trans Adriatik (projekti TAP).".

2. Pika 2 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"2. Vendosja në dispozicion të shoqërisë Trans Adriatic Pipeline AG (TAP AG) e sipërfaqes së tokës shtetërore do të bëhet nëpërmjet marrjes në përdorim të përhershëm, me kompensim, sipas planit për rehabilitimin e jetesës, përcaktuar në përputhje me pikën 2, të pjesës 3, të shtojcës 1, të marrëveshjes me qeverinë e vendit pritës, ratifikuar me ligjin nr. 116/2013, të sipërfaqes prej 87 363.01 (tetëdhjetë e shtatë mijë e treqind e gjashtëdhjetë e tre pikë zero një) m$^2$ dhe me vlerë totale kompensimi prej 34 387 035.69 (tridhjetë e katër milionë e treqind e tetëdhjetë e shtatë mijë e tridhjetë e pesë pikë gjashtëdhjetë e nëntë) lekësh për tokat shtetërore publike, të kategorizuara si toka bujqësore, rrugë automobilistike, si dhe kanal, të përcaktuara në shtojcën 1 bashkëlidhur këtij vendimi, referuar hartave dhe planeve përkatëse të rilevimit.".

3. Pika 3 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"3. Sipërfaqja e tokës shtetërore, që do të vendoset në dispozicion të përhershëm të

shoqërisë TAP AG, sipas formës së përdorimit me vlerën përkatëse të kompensimit, të përcaktuar në pikën 2, për ndërtimin e infrastrukturës mbi tokë të projektit TAP, përfshihet në territorin administrativ të njësive të qeverisjes vendore, si më poshtë vijon:

a) Në territorin administrativ të Bashkisë Skrapar, të qarkut të Beratit, për:

i. sipërfaqen tokë bujqësore (arë dhe ledh) prej 4 185 (katër mijë e njëqind e tetëdhjetë e pesë) $m^2$, me vlerë të përgjithshme kompensimi prej 696 311.00 (gjashtëqind e nëntëdhjetë e gjashtë mijë e treqind e njëmbëdhjetë) lekësh, prej së cilës sipërfaqja e re pas përditësimeve kadastrale prej 2 883 (dy mijë e tetëqind e tetëdhjetë e tre) $m^2$, me vlerë kompensimi prej 407 267.00 (katërqind e shtatë mijë e dyqind e gjashtëdhjetë e shtatë) lekë;

ii. sipërfaqen rrugë automobilistike prej 305 (treqind e pesë) $m^2$, me vlerë të përgjithshme kompensimi prej 56 000.00 (pesëdhjetë e gjashtë mijë) lekësh, prej së cilës sipërfaqja e re pas përditësimeve kadastrale prej 250 (dyqind e pesëdhjetë) $m^2$ me kompensim shtesë 0 (zero) lekë duke qenë se përfshihet në minimumin e kompensimit prej 56 000.00 (pesëdhjetë e gjashtë mijë) lekësh të paguar.

b) Në territorin administrativ të Bashkisë Devoll, të qarkut të Korçës, për:

i. sipërfaqen tokë bujqësore (arë dhe ledh) prej 4 657 (katër mijë e gjashtëqind e pesëdhjetë e shtatë) $m^2$, me vlerë të përgjithshme kompensimi prej 2 672 659.00 (dy milionë e gjashtëqind e shtatëdhjetë e dy mijë e gjashtëqind e pesëdhjetë e nëntë) lekësh, prej së cilës sipërfaqja e re pas përditësimeve kadastrale prej 4 458 (katër mijë e katërqind e pesëdhjetë e tetë) $m^2$, me vlerë kompensimi prej 2 616 659.00 (dy milionë e gjashtëqind e gjashtëmbëdhjetë mijë e gjashtëqind e pesëdhjetë e nëntë) lekësh;

ii. sipërfaqen kanal prej 18 141 (tetëmbëdhjetë mijë e njëqind e dyzet e një) $m^2$, me vlerë të përgjithshme kompensimi prej 3 555 636.00 (tre milionë e pesëqind e pesëdhjetë e pesë mijë e gjashtëqind e tridhjetë e gjashtë) lekësh, prej së cilës sipërfaqja e re pas përditësimeve kadastrale prej 12 027 (dymbëdhjetë mijë e njëzet e shtatë) $m^2$, me vlerë kompensimi prej 2 357 292.00 (dy milionë e treqind e pesëdhjetë e shtatë mijë e dyqind e nëntëdhjetë e dy) lekësh;

iii. sipërfaqen rrugë automobilistike prej 3 401 (tre mijë e katërqind e një) $m^2$, me vlerë të përgjithshme kompensimi prej 666 596.00 (gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e pesëqind e nëntëdhjetë e gjashtë) lekësh, prej së cilës sipërfaqja e re pas përditësimeve kadastrale prej 3 222 (tre mijë e dyqind e njëzet e dy) $m^2$, me vlerë kompensimi prej 631 512.00 (gjashtëqind e tridhjetë e një mijë e pesëqind e dymbëdhjetë) lekësh.

c) Në territorin administrativ të Bashkisë Fier, të qarkut të Fierit, për:

i. sipërfaqen tokë bujqësore (arë) prej 31 589.01 (tridhjetë e një mijë e pesëqind e tetëdhjetë e nëntë pikë zero një) $m^2$, me vlerë të përgjithshme kompensimi prej 20 382 250.69 (njëzet milionë e treqind e tetëdhjetë e dy mijë e dyqind e pesëdhjetë pikë gjashtëdhjetë e nëntë) lekësh, e gjitha për t'u paguar sipas pikës 2.2 më sipër;

ii. sipërfaqen kanal prej 10 719 (dhjetë mijë e shtatëqind e nëntëmbëdhjetë) $m^2$, me vlerë të përgjithshme kompensimi prej 2 690 469.00 (dy milionë e gjashtëqind e nëntëdhjetë mijë e katërqind e gjashtëdhjetë e nëntë) lekësh, prej së cilës sipërfaqja e re pas përditësimeve kadastrale prej 4 187 (katër mijë e njëqind e tetëdhjetë e shtatë) $m^2$, me vlerë kompensimi prej 1 050 937.00 (një milion e pesëdhjetë mijë e nëntëqind e tridhjetë e shtatë) lekësh;

iii. sipërfaqen rrugë automobilistike prej 13 340 (trembëdhjetë mijë e treqind e dyzet) $m^2$, me vlerë të përgjithshme kompensimi prej 3 363 304.00 (tre milionë e treqind e gjashtëdhjetë e tre mijë e treqind e katër) lekësh, prej së cilës sipërfaqja e re pas përditësimeve kadastrale prej 2 669 (dy mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e nëntë) $m^2$, me vlerë kompensimi prej 684 883.00 (gjashtëqind e tetëdhjetë e katër mijë e tetëqind e tetëdhjetë e tre) lekësh.

ç) Në territorin administrativ të Bashkisë Korçë, të qarkut të Korçës, për:

i. sipërfaqen tokë bujqësore (arë) prej 741 (shtatëqind e dyzet e një) $m^2$, me vlerë të përgjithshme kompensimi prej 244 530.00 (dyqind e dyzet e katër mijë e pesëqind e tridhjetë) lekësh, e gjitha për t'u paguar sipas pikës 2.2 më sipër;

ii. sipërfaqen rrugë automobilistike prej 285 (dyqind e tetëdhjetë e pesë) $m^2$, me vlerë të përgjithshme kompensimi prej 59 280.00 (pesëdhjetë e nëntë mijë e dyqind e tetëdhjetë) lekësh, e gjitha për t'u paguar sipas pikës 2.2 më sipër.".

4. Pika 8 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"8. E drejta e përdorimit të përhershëm dhënë shoqërisë TAP AG sipas këtij vendimi do të regjistrohet në regjistrat e pasurive të paluajtshme, administruar nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë kërkon pasqyrimin e të drejtave të përdorimit të përhershëm në regjistrat e pasurive të paluajtshme administruar nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës. Shoqëria TAP AG paraqet gjithë dokumentacionin e nevojshëm për regjistrim pranë drejtorive vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Fier; Berat; Skrapar; Lushnjë; Devoll dhe Korçë, në përputhje me kërkesat e ligjit 111/2018, "Për kadastrën".".

II. Vlera e kompensimit shtesë për sipërfaqet e reja prej 62 311.01 (gjashtëdhjetë e dy mijë e treqind e njëmbëdhjetë pikë zero një) m², të identifikuara pas përditësimeve kadastrale dhe që shoqëria TAP AG duhet t'i paguajë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë sipas shtojcës 1 të këtij vendimi, është 28 434 610.69 (njëzet e tetë milionë e katërqind e tridhjetë e katër mijë e gjashtëqind e dhjetë pikë gjashtëdhjetë e nëntë) lekë.

Pagesa për tokën shtetërore nga ana e shoqërisë TAP AG bëhet sipas vlerës së përcaktuar në pikën 2, të këtij vendimi, në bazë të një kontrate për pagesën e vlerës së kompensimit të lidhur ndërmjet Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë dhe shoqërisë TAP AG.

III. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, drejtoritë vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës sipas përkatësive për bashkitë ku kalon projekti i Gazsjellësit Trans Adriatik (projekti TAP), si dhe njësitë e qeverisjes vendore, ku kalon projekti i Gazsjellësit Trans Adriatik (projekti TAP), për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
**Erion Braçe**

Shtojcë 1

Lista e pronave që preken nga ndërtimi i infrastrukturës të përhershme mbi tokë të projektit të Gazsjellësit Trans Adriatik (projekti TAP) sipas njësive të qeverisjes vendore që do të kompensohet

| Nr. | Nr_i pasurisë | ZK | Lloji i pasurisë | Pronari | Indeksi i hartës | Njësia Administrative | NJQV | Bashkia | Sip. e pas. (m²) | Korridori Infrastrukturë e përhershme | | | | | Vlera e bimësisë (lek) (ishte) | Vlera e bimësisë (lek) (bëhet) | Kompensimi real (lek) (ishte) i paguar | Kompensimi real (lek) (bëhet) | Kompensimi që duhet paguar |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | | | | | Sipërfaqja (m²) (ishte) | Sipërfaqja (m²) (bëhet) | | Kompensimi (lek) (ishte) | Kompensimi (lek) (bëhet) | | | | | |
| 1 | 3/2 | 3076 | Arë | Shtet | K-34-125-(138-A | Potom | Skrapar | Skrapar | 14661 | 257 | 2134 | 1877 | 53,970.00 | 448,140.00 | 3,084.00 | - | 57,054.00 | 448,140.00 | 391,086.00 |
| 2 | 413 | 3596 | Ledh | Shtet | K-34-125-(100-B) | Vëndreshë | Skrapar | Skrapar | 2338 | 1045 | 2051 | 1006 | 219,450.00 | 223,559.00 | 12,540.00 | 24,612.00 | 231,990.00 | 248,171.00 | 16,181.00 |
| 3 | 799/13 | 3644 | Arë | Shtet | K-34-127-(49-C) | Bilisht | Devoll | Devoll | 5849 | 657 | 0 | -657 | 128,772.00 | - | 7,884.00 | - | 136,656.00 | - | - |
| 4 | 799/22 | 3644 | Arë | Shtet | K-34-127-(65-A) | Bilisht | Devoll | Devoll | 1491 | 199 | 1293 | 1094 | 39,004.00 | 652,965.00 | 2,388.00 | - | 56,000.00 | 652,965.00 | 596,965.00 |
| 5 | 6/10 | 3300 | Arë | Shtet | K-34-111-(159-C) | Topojë | Fier | Fier | 52,958 | 14566 | 0 | -14566 | 12,060,648.00 | - | 174,792.00 | - | 12,235,440.00 | - | - |
| 6 | 1088/7 | 3644 | Rrugë | Shtet | K-34-127 | Bilisht | Devoll | Devoll | 476 | 249 | 179 | -70 | 48,804.00 | 35,084.00 | 0 | - | 56,000.00 | 35,084.00 | - |
| 7 | 1852 | 3644 | Kanal | Shtet | K-34-127-(65-A) | Bilisht | Devoll | Devoll | 1782 | 1,274 | 2776 | 1502 | 249,704.00 | 544,096.00 | 0 | - | 249,704.00 | 544,096.00 | 294,392.00 |
| 8 | 1908 | 3644 | Kanal | Shtet | K-34-127-(65-A) | Bilisht | Devoll | Devoll | 13615 | 4,032 | 0 | -4032 | 790,272.00 | - | 0 | - | 790,272.00 | - | - |
| 9 | 1558 | 3787 | Kanal | Shtet | K-34-127-65-A | Bilisht | Devoll | Devoll | 3058 | 2,405 | 1647 | -758 | 471,380.00 | 322,812.00 | 0 | - | 471,380.00 | 322,812.00 | - |
| 10 | 1561 | 3787 | Kanal | Shtet | K-34-127-65-A | Bilisht | Devoll | Devoll | 7530 | 2,010 | 529 | -1481 | 393,960.00 | 103,684.00 | 0 | - | 393,960.00 | 103,684.00 | - |
| 11 | 1569 | 3787 | Kanal | Shtet | K-34-127-65-A | Bilisht | Devoll | Devoll | 5993 | 3,653 | 2664 | -989 | 715,988.00 | 522,144.00 | 0 | - | 715,988.00 | 522,144.00 | - |
| 12 | 114 | 3300 | Rrugë | Shtet | K-34-111-(159-C,159-D) | Topojë | Fier | Fier | 6062 | 4,412 | 3749 | -663 | 1,107,412.00 | 940,999.00 | 0 | - | 1,107,412.00 | 940,999.00 | - |
| 13 | 115 | 3300 | Rrugë | Shtet | K-34-111-(159-C,159-D) | Topojë | Fier | Fier | 5295 | 3,345 | 3273 | -72 | 839,595.00 | 821,523.00 | 0 | - | 839,595.00 | 821,523.00 | - |
| 14 | 154 | 3300 | Kanal | Shtet | K-34-111-(175-B) | Topojë | Fier | Fier | 9048 | 3,147 | 2296 | -851 | 789,897.00 | 576,296.00 | 0 | - | 789,897.00 | 576,296.00 | - |
| 15 | 155 | 3300 | Kanal | Shtet | K-34-111-(175-B) | Topojë | Fier | Fier | 6791 | 5,499 | 4236 | -1263 | 1,380,249.00 | 1,063,236.00 | 0 | - | 1,380,249.00 | 1,063,236.00 | - |
| 16 | 3/8 | 3300 | Rrugë | Shtet | K-34-111-(159-D) | Topojë | Fier | Fier | 5364 | 4,062 | 3649 | -413 | 1,019,562.00 | 915,899.00 | 0 | - | 1,019,562.00 | 915,899.00 | - |
| 17 | 412 | 3596 | Rrugë | Shtet | K-34-125-(100-B) | Vëndreshë | Skrapar | Skrapar | 841 | 55 | 305 | 250 | 56,000.00 | 33,245.00 | 0 | - | 56,000.00 | 56,000 | - |
| 18 | 1158 | 3787 | Kanal | Shtet | K-34-127-(49-C) | Vishocicë | Bilisht | Devoll | 485 | - | 409 | 409 | - | 80,164.00 | - | - | - | 80,164.00 | 80,164.00 |
| 19 | 1847 | 3787 | Kanal | Shtet | K-34-127-(65-A) | Vishocicë | Bilisht | Devoll | 479 | - | 479 | 479 | - | 93,884.00 | - | - | - | 93,884.00 | 93,884.00 |
| 20 | 5/10 | 3300 | Arë | Shtet | K-34-111-(159-C) | Seman | Topojë | Fier | 1600 | - | 1600 | 1600 | - | 1,038,400.00 | - | - | - | 1,038,400.00 | 1,038,400.00 |
| 21 | 6/13 | 3300 | Arë | Shtet | K-34-111-(159-C) | Seman | Topojë | Fier | 3863 | - | 3903 | 3903 | - | 3,231,684.00 | - | - | - | 3,231,684.00 | 3,231,684.00 |
| 22 | 5095 | 3787 | Kanal | Shtet | K-34-127-(49-A) | Vishocicë | Bilisht | Devoll | 1263 | - | 274 | 274 | - | 53,704.00 | - | - | - | 53,704.00 | 53,704.00 |
| 23 | 6/19 | 3300 | Arë | Shtet | K-34-111-(159-C) | Seman | Topojë | Fier | 1700 | - | 1700 | 1700 | - | 1,103,300.00 | | | - | 1,103,300.00 | 1,103,300.00 |
| 24 | 5/51 | 3300 | Rrugë | Shtet | K-34-111-(159-C) | Seman | Topojë | Fier | 1087 | - | 1087 | 1087 | - | 272,837.00 | - | - | - | 272,837.00 | 272,837.00 |
| 25 | 5088 | 3787 | Ledh | Shtet | K-34-126-(49-A) | Vishocicë | Bilisht | Devoll | 358 | - | 341 | 341 | - | 66,836.00 | - | - | - | 66,836.00 | 66,836.00 |
| 26 | 5090 | 3787 | Rrugë | Shtet | K-34-126-(49-C) | Vishocicë | Bilisht | Devoll | 9628 | - | 1987 | 1987 | - | 389,452.00 | - | - | - | 389,452.00 | 389,452.00 |
| 27 | 5089 | 3787 | Kanal | Shtet | K-34-126-(64-D) | Vishocicë | Bilisht | Devoll | 7736 | - | 3928 | 3928 | - | 769,888.00 | - | - | - | 769,888.00 | 769,888.00 |
| 28 | 5/21 | 3300 | Arë | Shtet | K-34-111-(156-C) | Seman | Topojë | Fier | 2000 | - | 2000 | 2000 | - | 938,000.00 | - | - | - | 938,000.00 | 938,000.00 |
| 29 | 1/28 | 3300 | Arë | Shtet | K-34-111-(159-C) | Seman | Topojë | Fier | 1540 | - | 1208 | 1208 | - | 566,552.00 | - | - | - | 566,552.00 | 566,552.00 |
| 30 | 6/27 | 3300 | Arë | Shtet | K-34-111-(159-C) | Seman | Topojë | Fier | 635 | - | 635 | 635 | - | 297,815.00 | - | - | - | 297,815.00 | 297,815.00 |
| 31 | 5086 | 3787 | Kanal | Shtet | K-34-127-(65-A) | Vishocicë | Bilisht | Devoll | 1511 | - | 1511 | 1511 | - | 296,156.00 | - | - | - | 296,156.00 | 296,156.00 |
| 32 | 5096 | 3787 | Kanal | Shtet | K-34-126-(49-C) | Vishocicë | Bilisht | Devoll | 4180 | - | 2612 | 2612 | - | 511,952.00 | - | - | - | 511,952.00 | 511,952.00 |
| 33 | 1/36 | 3300 | Arë | Shtet | K-34-111-(159-C) | Seman | Topojë | Fier | 1930 | - | 1520 | 1520 | - | 712,880.00 | - | - | - | 712,880.00 | 712,880.00 |
| 34 | 1/35 | 3300 | Arë | Shtet | K-34-111-(159-C) | Seman | Topojë | Fier | 1540 | - | 1210 | 1210 | - | 567,490.00 | - | - | - | 567,490.00 | 567,490.00 |
| 35 | 6/20 | 3300 | Arë | Shtet | K-34-111-(159-C) | Seman | Topojë | Fier | 2583 | - | 2583 | 2583 | - | 1,676,367.00 | - | - | - | 1,676,367.00 | 1,676,367.00 |
| 36 | 75/1 | 3358 | Arë | Shtet | K-34-111-(159-C) | Sheq Marinas | Topojë | Fier | 1102 | - | 851 | 851 | - | 552,299.00 | - | - | - | 552,299.00 | 552,299.00 |
| 37 | 6/16 | 3300 | Arë | Shtet | K-34-111-(159-C) | Seman | Topojë | Fier | 1950 | - | 1950 | 1950 | - | 1,265,550.00 | - | - | - | 1,265,550.00 | 1,265,550.00 |
| 38 | 75/2 | 3358 | Rrugë | Shtet | K-34-111-(159-C) | Sheq-Marinas | Topojë | Fier | 3290 | - | 78 | 78 | - | 19,578.00 | 0 | | - | 19,578.00 | 19,578.00 |
| 39 | 75 | 3358 | Arë | Shtet | K-34-111-(159-C) | Sheq-Marinas | Topojë | Fier | 71003 | - | 1370 | 1370 | - | 889,130.00 | - | - | - | 889,130.00 | 889,130.00 |
| 40 | 3/12 | 3300 | Arë | Shtet | K-34-111-(159-D) | Seman | Topojë | Fier | 1560 | - | 1560 | 1560 | - | 731,640.00 | - | - | - | 731,640.00 | 731,640.00 |

| | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 41 | 326 | 3358 | Kanal | Shtet | K-34-111-(159-C) | Sheq-Marinas | Topojë | Fier | 6034 | - | 221 | 221 | - | 55,471.00 | 0 | 0 | - | 55,471.00 | 55,471.00 |
| 42 | 202 | 3300 | Kanal | Shtet | K-34-111-(159-C) | Seman | Topojë | Fier | 3966 | - | 3966 | 3966 | - | 995,466.00 | - | - | - | 995,466.00 | 995,466.00 |
| 43 | 1561 | 3644 | Kanal | Shtet | K-34-127-(65-A) | Trestenik | Bilisht | Devoll | 294 | - | 126 | 126 | - | 24,696.00 | - | - | - | 24,696.00 | 24,696.00 |
| 44 | 6/17 | 3300 | Arë | Shtet | K-34-111-(159-C) | Seman | Topojë | Fier | 1500 | - | 1500 | 1500 | - | 973,500.00 | - | - | - | 973,500.00 | 973,500.00 |
| 45 | 6/21 | 3300 | Arë | Shtet | K-34-111-(159-C) | Seman | Topojë | Fier | 2799 | - | 402 | 402 | - | 188,538.00 | - | - | - | 188,538.00 | 188,538.00 |
| 46 | 6/15 | 3300 | Arë | Shtet | K-34-111-(159-C) | Seman | Topojë | Fier | 2000 | - | 2000 | 2000 | - | 1,298,000.00 | - | - | - | 1,298,000.00 | 1,298,000.00 |
| 47 | 8/25 | 3358 | Rrugë | Shtet | K-34-111-(157-C) | Sheq-Marinas | Topojë | Fier | 4338 | - | 257 | 257 | - | 64,507.00 | 0 | | - | 64,507.00 | 64,507.00 |
| 48 | 3/36 | 3300 | Arë | Shtet | K-34-111-(159-D) | Seman | Topojë | Fier | 395 | - | 395 | 395.01 | - | 185,259.69 | - | - | - | 185,259.69 | 185,259.69 |
| 49 | 7548 | 3644 | Kanal | Shtet | K-34-127-(65-A) | Trestenik | Bilisht | Devoll | 2382 | - | 1186 | 1186 | - | 232,456.00 | - | - | - | 232,456.00 | 232,456.00 |
| 50 | 3/9 | 3300 | Arë | Shtet | K-34-111-(176-D) | Seman | Topojë | Fier | 790 | - | 790 | 790 | - | 512,710.00 | - | - | - | 512,710.00 | 512,710.00 |
| 51 | 6/11 | 3300 | Rrugë | Shtet | K-34-111-(159-C) | Seman | Topojë | Fier | 2739 | - | 1247 | 1247 | - | 312,997.00 | 0 | 14964 | - | 327,961.00 | 327,961.00 |
| 52 | 1069/28 | 3644 | Rrugë | Shtet | K-34-127-(80-B) | Trestenik | Bilisht | Devoll | 4367 | - | 1235 | 1235 | - | 242,060.00 | - | - | - | 242,060.00 | 242,060.00 |
| 53 | 10/16 | 3196 | Arë | Shtet | K-34-112-(183-A) | Roskovec | Roskovec | Fier | 1755 | - | 392 | 392 | - | 324,576.00 | - | - | - | 324,576.00 | 324,576.00 |
| 54 | 6/14 | 3300 | Arë | Shtet | K-34-112-(183-A) | Seman | Topojë | Fier | 4020 | - | 4020 | 4020 | - | 3,328,560.00 | - | - | - | 3,328,560.00 | 3,328,560.00 |
| 55 | 1088/20 | 3644 | Arë | Shtet | K-34-127-(65-A) | Trestenik | Bilisht | Devoll | 3023 | - | 3023 | 3023 | - | 1,952,858.00 | - | - | - | 1,952,858.00 | 1,952,858.00 |
| 56 | 304/21 | 3437 | Arë | Shtet | K-34-126-(114-A) | Shtyllë | Vithkuq | Korçë | 741 | - | 741 | 741 | - | 244,530.00 | - | - | - | 244,530.00 | 244,530.00 |
| 57 | 378 | 3016 | Rrugë | Shtet | K-34-126-(55-A) | Polenë | Voskop | Korçë | 4,594 | - | 285 | 285 | - | 55,860 | - | 3,420 | - | 59,280.00 | 59,280.00 |
| | | | **Totali** | | | | | **Totali** | **311,915.14** | **50,867.00** | **87,363.01** | | **20,364,667.00** | **34,321,284.69** | **200,688.00** | **42,996.00** | **20,587,159.00** | **34,387,035.69** | **28,434,610.69** |

**URDHËR**
**Nr. 99/2, datë 29.6.2021**

**PËR NJË NDRYSHIM NË URDHRIN NR. 99, DATË 10.2.2021, "PËR KUFIZIMIN E LËVIZJES BRENDA VENDIT", TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të nenit 7, pika 4, germa "d", të ligjit nr. 15/2016, "Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive", sipas udhëzimeve të Institutit të Shëndetit Publik, në zbatim të vendimit të Komitetit të Përkohshëm për Infeksionin e Përhapur nga Coronavirusi i ri nr. 2435, datë 27.5.2021, me qëllim mbrojtjen e shëndetit të popullatës nga infeksioni i shkaktuar nga COVID-19,

URDHËROJ:

Në urdhrin nr. 99, datë 10.2.2021, "Për kufizimin e lëvizjes brenda vendit", të ndryshuar, bëhet ndryshimi si vijon:

1. Në pikën 1 të urdhrit togfjalëshi "nga ora 23:00" zëvendësohet me togfjalëshin "nga ora 24:00".

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë, i fillon efektet më datë 1.7.2021, dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I SHËNDETËSISË
DHE MBROJTJES SOCIALE
**Ogerta Manastirliu**

**URDHËR**
**Nr. 270/2, datë 30.6.2021**

**PËR NJË NDRYSHIM DHE NJË SHTESË NË URDHRIN NR. 351, DATË 29.5.2020, "PËR MARRJEN E MASAVE TË VEÇANTA DHE KUFIZIMEVE PËR PARANDALIMIN E PËRHAPJES SË COVID-19", TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të nenit 7, pika 4, të ligjit nr. 15/2016, "Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive"; të udhëzimeve të Institutit të Shëndetit Publik, me qëllim mbrojtjen e shëndetit të popullatës nga infeksioni i shkaktuar nga COVID-19; të nenit 113, të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë", si edhe të vendimit të Komitetit Teknik nr. 2435, datë 27.5.2021,

URDHËROJ:

Në urdhrin nr. 351, datë 29.5.2020, "Për marrjen e masave të veçanta dhe kufizimeve për parandalimin e përhapjes së COVID-19", të ndryshuar, bëhet ndryshimi dhe shtesa si më poshtë vijon:

1. Në pikën 3, germa "b" shfuqizohet.
2. Pas pikës 2 shtohet pika 2/1 me përmbajtje si vijon:

"2/1 Aktivitetet kulturore dhe teatrot të zhvillohen me kapacitet të reduktuar deri në 30% të spektatorëve apo pjesëmarrësve, në përputhje me protokollet e miratuara për parandalimin e përhapjes së infeksionit COVID-19 nga Instituti i Shëndetit Publik.".

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë, i fillon efektet më datë 1.7.2021 dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I SHËNDETËSISË
DHE MBROJTJES SOCIALE
**Ogerta Manastirliu**

**URDHËR**
**Nr. 321, datë 29.6.2021**

**PËR SHFUQIZIMIN E URDHRIT NR. 326, DATË 15.5.2020, "PËR KUFIZIMIN E AKTIVITETEVE SPORTIVE", TË NDRYSHUAR, DHE LEJIMIN E KAMPIONATEVE SPORTIVE ME PREZENCË TË TIFOZËVE ME KAPACITETE TË REDUKTUARA DERI NË 30%**

Në zbatim të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës, nenit 7, pika 4, germa "b", të ligjit nr. 15/2016 "Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive", të ndryshuar, nenit 113 të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë", në zbatim të udhëzimeve të Institutit

të Shëndetit Publik, si dhe vendimit të Komitetit Teknik nr. 2435, datë 27.5.2021,

URDHËROJ:

1. Shfuqizimin e urdhrit nr. 326, datë 15.5.2020, "Për kufizimin e aktiviteteve sportive", të ndryshuar.

2. Lejohen kampionatet sportive me prezencë të tifozëve me kapacitete të reduktuara deri në 30% sipas protokollit të miratuar nga Instituti i Shëndetit Publik.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë, i fillon efektet më datë 1.7.2021 dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I SHËNDETËSISË
DHE MBROJTJES SOCIALE
**Ogerta Manastirliu**

## URDHËR
## Nr. 324, datë 6.7.2021

## PËR SHFUQIZIMIN E URDHRIT TË MINISTRIT NR. 131, DATË 8.3.2020, "PËR NDALIMIN E EKSPORTIT TË BARNAVE DHE PAJISJEVE MJEKËSORE"

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të nenit 113, të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë",

URDHËROJ:

1. Shfuqizimin e urdhrit nr. 131, datë 8.3.2020, "Për ndalimin e eksportit të barnave dhe pajisjeve mjekësore".

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I SHËNDETËSISË
DHE MBROJTJES SOCIALE
**Ogerta Manastirliu**

## KËRKESË
## Nr. 304, datë 15.7.2021

## PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë shpall kërkesën për shpronësim për interes publik të pasurive, pronë private, që preken nga zbatimi i projektit "Përmirësimi i furnizimit me ujë të pijshëm për qytetin e Roskovecit".

Subjekti kërkues i këtij projekti është Bashkia Roskovec.

Me anë të këtij publikimi kërkojmë të vëmë në dijeni personat e prekur nga ky shpronësim për pasuritë, pronë private, të cilat do të kompensohen sipas vlerësimit paraprak të llogaritur, bazuar në VKM-në nr. 89, datë 3.2.2016, "Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë", dhe në VKM-në nr. 138, datë 23.8.2000, "Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përllogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive, pronë private, që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik", të ndryshuar, sipas tabelës paraprake bashkëlidhur.

Referuar pikës 2, të nenit 15, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, "Për shpronësimet publike dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik", të ndryshuar, keni të drejtë që, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga data e publikimit të kërkesës në Fletoren Zyrtare të paraqitni pretendimet tuaja, nëse keni, pranë Bashkisë Roskovec, si dhe në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë.

Vlera totale paraprake e shpronësimit është 971,548.75 (nëntëqind e shtatëdhjetë e një mijë e pesëqind e dyzetë e tetë pikë shtatëdhjetë e pesë) lekë.

KRYETAR I KOMISIONIT TË POSAÇËM
TË SHPRONËSIMEVE
**Erlis Hereni**

**Lista paraprake e pronarëve, pronë private, që shpronësohen nga realizimi i projektit "Përmirësimi i furnizimit me ujë të pijshëm për qytetin e Roskovecit"**

| Nr. | Emër Atësi Mbiemër | Nr. i pasurisë | ZK | Sipërfaqja e parcelës sipas kartelës së pronësisë m² | Sip. e tokës së prekur m² | Çmimi lekë/m² | Vlera e tokës | Lloji i kulturës bujqësore | Vlera e kulturës/dy | Vlera në lekë e kulturës | Vlera totale lekë | Shënime sqaruese |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Defrim Barjam Hoxha | 63/36 | 3767 | 4759 | 1074 | 269 | 288906 | Misër | 17125 | 18392.25 | 307298 | **Certifikatë pronësie** |
| 2 | Hekuran Bajram Mamo | 64/27 | 3767 | 3257 | 1074 | 269 | 288906 | Misër | 17125 | 18392.25 | 307298 | **Certifikatë pronësie** |
| 3 | Aqif Caush Hoxha, Emine Shaip Hoxha | 66/4 | 3767 | 5455 | 1284 | 269 | 345396 | Tërfil | 9000 | 11556 | 356952 | **Certifikatë pronësie** |
| **Vlera totale paraprake** | | | | | **3432.0** | | **923208** | | | **48341** | **971549** | |

1. *Vlerësimi për kulturën bujqësore është kryer bazuar në VKM-në nr. 138, datë 23.3.2000.*
2. *Vlerësimi i pasurisë së llojit "tokë arë" është kryer në VKM-në nr. 89, datë 3.2.2016.*

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Vulosur elektronikisht nga Qendra e Botimeve Zyrtare
Viti: 2021 - Numri: 114
Datë: 2021/07/19 14:06:58
346d2b6b-324f-4a9e-a428-f89abde98f46

*Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë të një procedure automatike nga një sistem elektronik (Qendra e Botimeve Zyrtare)*

| | |
|---|---|
| | Formati 61x86/8 |

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2021

Adresa: Rr. “Nikolla Jorga”, Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 48 lekë